

MASTER NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT NË GJUHË-LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi dhe Qytetërim Grek						
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Ne proces akreditimi						
Cikli i studimit	Cikli i dytë						
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe i Shkencave Shoqërore, Institucion Publik, Akredituar						
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Greqisht, Shqip						
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite						
Forma e studimit	Me kohë të plotë						
Kushtet e pranimit	1. Pranimi i studentëve në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, i cili jep akses në programet e ciklit të dytë të studimeve, në fushën e mësuesisë. 2. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (<i>anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B₁, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. <table border="1" style="margin-top: 20px;"> <tr> <td style="text-align: center;">Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”</td><td> a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë. </td></tr> <tr> <td style="text-align: center;">Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit</td><td>Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.</td></tr> <tr> <td style="text-align: center;">Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit</td><td>Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.</td></tr> </table>	Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “ <i>Bachelor</i> ”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “ <i>Bachelor</i> ”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.
Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.						
Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “ <i>Bachelor</i> ”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.						
Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “ <i>Bachelor</i> ”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.						

	3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ciklit të parë “Bachelor”, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas: - Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve Master profesional në “Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke”. - Notës mesatare në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”.
--	--

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit “**Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi dhe Qytetërim Grek**” është të aftësojë studentët nëpërgatitjen e tyre të plotë profesionale si mësues, të cilët do të shërbejnë në shkolla. Në veçanti: synohet aftësimi shkencor dhe didaktik i studentëve në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së disiplinave në përputhje me format dhe teknikat bashkëkohore që përdoren në shkollë, me qëllim përvetësimin aktiv dhe të qëndrueshëm të njohurive dhe vlerësimit të tyre në bazë të standardeve të arritjeve.

Gjithashtu, synohet në rritjen e kompetencës së tyre shkencore në disiplinat teorike, në mënyrë që mësimdhënien të jetë e plotë, efektive dhe rezultative. Në këtë mënyrë, programi synon t’i japë arsimit të mesëm të ulët një potencial kuadrosh të arsimuar në mënyrë të përshtatshme, duke ngritur në një shkallë më të lartë atë ekzistues dhe duke modernizuar mësimdhënien në mësimin e gjuhës dhe letërsisë, në përputhje me kërkimet dhe arritjet e reja në didaktikën moderne.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre të plotë për të ushtruar profesionin e mësuesit.
2. Të integrojnë njohuritë e fituara në fushën e gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit grek me ato psikopedagogjike.
3. Të aftësohet në procesin e mësimdhënies për nivelin e arsimit të mesëm të ulët në shkollat e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri.
4. Të jetë i aftë për të punuar në grupe shoqërore me karakteristika të veçanta sociale, kulturore e psikologjike.
5. Të aftësohet për të zbërthyer planet dhe programet mësimore të arsimit parauniversitar.
6. Të jetë në gjendje të hartojë planet edukative të klasës në përputhje me temperamentin dhe veçoritë psiko - sociale të nxënësve.
7. Të aftësohet si një menaxhues kompetent për harmonizimin e problemeve shkollë - familje - komunitet.
8. Të jetë në gjendje që njohuritë që zotëron në fushën e gjuhës dhe letërsisë greke t’i harmonizojë me edukimin qytetar.
9. Të harmonizojë njohuritë që përcjell të nxënësi në përputhje me filozofinë e të menduarit kritik e krijues.
10. Të evidentojë dhe të edukojë frymën e integritetit, globalizmit, tolerancës e të jetuarit në harmoni.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e *mësuesit në AMU në gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek*.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi të lidhura me mësimdhënien, komunikimin pedagogjik dhe ndjeshmërinë ndërkulturore, që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin arsimor, kulturor dhe shumëgjuhësh, në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të gjuhës dhe letërsisë greke, didaktikës së gjuhës greke, metodologjisë së mësimdhënies, teknologjive arsimore, studimeve ndërkulturore, etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- 1. Lëndë të formimit të përgjithshëm:** *Letërsia moderne greke* (5 Ects); *Letërsia dhe Kultura në MEG* (6 Ects); *Kultura dhe historia moderne e Greqisë* (5 Ects). **Kredite në total 16.**
- 2. Lëndë të formimit karakterizues:** *Përdorimi i drejtë i gjuhës greke* (4 Ects); *Zhvillimi i të nxënit dhe i formave të ndryshme të të menduarit* (9 Ects); *Metodat e mësimdhënies të gjuhës greke dhe lëndëve shoqërore në gjuhën greke* (13 Ects); *Qasje koherente të psikologjisë së nxënësit në AMU* (6 Ects); *Metodat e kërkimit shkencor* (6 Ects); *Arsimi, legjislacioni, planifikimi dhe zëvillimi i krrikulave dhe i praktikës gjuhësore (gr.)* (5 Ects).
Kredite në total 43.
- 3. Lëndë integruese:** *Dyngjuhësia në mjedisin shkollor dhe shoqëror dhe proceset integruese* (9 Ects); *Nxënësi, shkolla, familja dhe komuniteti* (9 Ects); *Teknologjia dhe informatika në edukim* (5 Ects).
Kredite në total 23.
- 4. Lëndë me zgjedhje.**
Viti i parë: *Përkthimi dhe interpretimi; Diferencimi dhe toleranca në një mjedis multikulturor; Aplikimi dhe manaxhimi i një projekti* (6 Ects)
Viti i dytë: *Teksti dhe stili i tekstit në komunikim (shkrim i folur); Struktura shoqërore tradicionale, kujtesa kolektive dhe identiteti* (6 Ects)
Kredite në total 12.
- 5. Lëndë të formimit plotësues:** *Praktika shkollore e mësimdhënies afatshkurtër, pasive* (6 Ects); *Praktika emësimdhënies profesionale e plotë* (10 Ects)
Kredite në total 16.
- 6. Përgatitje punim diplome, Kredite 10**
Kredite në total 120

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75– 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95– 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të dytë “***Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi dhe Qytetërim Grek***” është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë bashkëkohore dhe e përqendruar në kompetenca është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj, detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e kërkimit shkencor, të avancimit pedagogjik dhe të përfshirjes aktive në arsimin ndërkulturor dhe europian.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit “***Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi dhe Qytetërim Grek***” mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë master shkencor apo në një program të doktoraturës (cikli i tretë) në fusha si: gjuhësi, letërsi, didaktikë e gjuhës, studime kulturore, apo në një fushë të ngjashme. Këto studime mund të realizohen në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokës, në universitete të tjera brenda ose jashtë vendit, që ofrojnë programe në fushat përkatëse. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë, në programet:

1. Doktoraturë në shkenca gjuhësore,
2. Doktoraturë në shkencat letrare,
3. Doktoraturë në Didaktikën e gjuhës greke,
4. Doktoraturë në Studime Ballkanike dhe Ndërkulturore,
5. Doktoraturë në Shkencat e Edukimit me fokus në mësimdhënie në mjedise shumëgjuhëshe.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon mësues të gjuhës greke në fushat e gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore, të kualifikuar me njohuri të tilla sididaktika e gjuhës, letërsia greke dhe lëndët shoqërore në gjuhën greke, kompetencat ndërkulturore, teknologjitë në arsim dhe metodologjinë bashkëkohore e mësimdhënies.

Për këtë arsye synimi i programit të studimit ciklit të dytë “***Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi dhe Qytetërim Grek***” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës, duke u pajisur me aftësi teorike dhe praktike për mësimdhënie efikase dhe të integruar.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Institucione arsimore publike dhe private në arsimin e mesëm të ulët në gjuhën greke.
2. Qendra të gjuhëve të huaja dhe kurse jashtëshkollore për mësimin e gjuhës greke.
3. Projekte dhe organizata ndërkombëtare që punojnë me komunitete dygjuhëshe ose pakica kombëtare.
4. Institucione arsimore dhe kulturore në Greqi, Shqipëri ose në vende të tjera me prezencë të gjuhës greke.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit ciklit të dytë “***Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim Grek***” fitojnë njohuri në teorinë dhe praktikën e mësimdhënies së gjuhës greke, analizën dhe interpretimin e teksteve letrare, përdorimin e teknologjisë në arsim, zhvillimin e materialeve mësimore, si dhe ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore në procesin edukativ. Ata pajisen gjithashtu me aftësi komunikimi, vlerësimi dhe menaxhimi të klasës, që janë thelbësore për një karrierë të suksesshme në arsim dhe fushat e lidhura me të.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Letërsiamoderne greke	5	60	I
2.	Letërsiadhekulturane MEG	6	75	II
3.	Kultura dhe historia moderne e Greqisë	5	60	I
4.	Përdorimi i drejtë i gjuhës greke Qasje koherente të psikologjisë së nxënësit në AMU (6 Ects);	4	52,5	I
5.	Zhvillimi i të nxënësit dhe i formave të ndryshme të të menduarit	9	112,5	I+II
6.	Metodat e mësimdhënies të gjuhës greke dhe lëndëve shoqërore në gjuhën greke	13	157,5	I+II
7.	Qasje koherente të psikologjisë së nxënësit në AMU	6	67,5	II
	Metodat e kërkimit shkencor	6	75	II
Lëndë me zgjedhje				
7.	Përkthimi dhe interpretimi	6	67,5	I
	Diferencimi dhe toleranca në një mjedis multikulturor;			
	Aplikimi dhe menaxhimi i një projekti			
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	727,5	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Arsimi, legjislacioni, planifikimi dhe zhvillimi i krrikulave dhe i praktikës gjuhësore (gr.)	5	60	IV
2.	Dygjuhësia në mjedisin shkollor dhe shoqëror dhe proceset integruese	9	112,5	IV
3.	Nxënësi, shkolla, familja dhe komuniteti	9	105	IV
4.	Teknologjia dhe informatika në edukim	5	52,5	III
	Lëndë me zgjedhje	6	67,5	III
	Teksti dhe sili i tekstit në komunikim (shkrim i folur)			
	Struktura shoqërore tradicionale, kujtesa kolektive dhe identiteti			
	Praktika shkollore e mësimdhënies afatshkurtër, pasive (6Ects);	6	75	III
	Praktika e mësimdhënies profesionale e plotë	10	200	IV
Provim formimi / Punim diplome		10	30	IV
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	702,5	
Total : viti I + viti II		120 ECTS	1430	